



Shërbimi Ligjor Falas Tiranë (TLAS)

PROJEKTLIGJI PER NDIHMEN JURIDIKE ESHTE GATI

Shërbimi Ligjor Falas Tiranë (TLAS) me mbështetjen e Ministrisë së Drejtësisë, me financimin e SOROS, SHC dhe Ambasadës së SHBA-së në Tiranë, si dhe me angazhimin e ekspertëve vendas dhe të huaj hartoij projekt-ligjin “Për Ndihmën Juridike”.



BASHKOHU ME NE!
TE GJITHE SE BASHKU TE NDERTOJME UREN MIDIS INDIVIDIT NE NEVOJE DHE SHTETIT TE SE DREJTES

Swedish Helsinki Committee
for Human Rights

Falenderojmë SHC për mbështetjen financiare të këtij botimi

Kush do ta ofrojë Ndihmën Juridike?

Ndihma Juridike do të ofrohet nga avokatët e autorizuar nga ligji, të cilët mund të jenë të organizuar si individë ose anëtarë të Zyrave të Avokatisë.

Ndihmë Juridike mund të ofrojnë gjithashtu OFJ-të që kanë si mision të ndihmojnë individët në nevojë, nëpërmjet avokatëve të tyre.




Si do të administrohet ofrimi i Ndihmës Juridike?

Shërbimi i Ndihmës Juridike të dhënë nga shteti për individët do të jetë përgjegjësi e Ministrisë së Drejtësisë, Dhomës Kombëtare të Avokatisë dhe e një Komisioni Shtetëror i ngritur posaçërisht për të administruar Ndihmën Juridike, të cilët do të:

- zhvillojnë politikën shtetërore në fushën e ndihmës juridike shtetërore për individët;

- mbrojtja dhe përfaqësimi i interesave të të dyshuarit, të akuzuarit dhe të dëmtuarit në procesin penal;
- mbrojtja dhe përfaqësimi i interesave të personave në çështjet civile ose administrative.



Cilat do të jenë parimet themelore që do të respektohen në ofrimin e Ndihmës Juridike?


- Barazia e të drejtave për të gjithë individët që përfitojnë nga ndihma juridike;
- Profesionalizmi i personave që jepin ndihmën juridike;
- Cilësia, efiçensa dhe efektiviteti i shërbimit të Ndihmës Juridike;
- Ruajtja e konfidencialitetit;
- Papranueshmëria e konfliktit të interesit në dhënien e Ndihmës Juridike.

- ndihmojnë në përgatitjen e akteve të nevojshme ligjore/nënligjore në fushën e shërbimit të ndihmës juridike;

- kujdesen për zbatimin e dispozitiveve ligjore dhe nënligjore për ndihmën juridike shtetërore dhe vlerësimin e cilësisë së ndihmës juridike të ofruar;
- përgatisin projektbuxhetin për ndihmën juridike shtetërore, në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- përcaktojnë kriteret për përzgjedhjen e avokatëve që do të jepin ndihmën juridike;

Kush do ta financojë ofrimin e Ndihmës Juridike?

Ndihma Juridike do të financohet nga Buxheti i Shtetit dhe Donator të ndryshëm.



Adresa e TLAS:

Rruga “Sami Frashëri”, 4 kullat, seksioni III,
Ap.1A, Tiranë, Shqipëri, Kutia postare nr.69
Tel/Fax: 00 355 42 258 442,
Tel: 00 355 42 253 114; www.tlas.org.al

Çfarë është Ndiham Juridike?

Ndiham Juridike është ofrimi i shërbimeve ligjore falas individëve që nuk kanë mjete të mjaftueshme financiare.

Pse është i nevojshëm ligji për ndihmën juridike në shqipëri?

Ndiham Juridike është instrumenti më efikas për ti garantuar individit aksesin në drejtësi. Përmes Ndiham Juridike çdo individ në pamundësi financiare mund të marrë mbështetjen e nevojshme për realizimin e të drejtave të tij. Krijimi i kushteve që çdo individ të këtë akses në drejtësi është një nga detyrat kryesore të shtetit për të siguruar dhe garantuar parimin e barazisë përparrë ligjit.




Projekt ligji për Ndiham Juridike në Shqipëri synon të përcaktojë standartet për dhënien e ndihmës juridike nga shteti me qëllim që të garantojë mbrojtjen sa më efikase të lirive dhe të drejtave themelore të individit, si dhe interesat e tjera të ligjshme të tij.



Cilët janë individët që do të përfitojnë Ndiham Juridike?

Individët që do të përfitojnë Ndiham Juridike janë të gjithë ato persona që janë pjesë e programeve të mbrojtjes sociale ose që plotësojnë kushtet për t'u përfshirë në to. Në grupin e ketyre individëve do të përfshihen edhe të miturit.




Cilat janë llojet e Ndihamës Juridike?

Ndiham Juridike parësore është dhënia e informacionit për sistemin ligjor në Republikën e Shqipërisë, aktet normative në fuqi, të drejtat dhe detyrimet e subjekteve të ligjit, mënyrat e ushtrimit të të drejtave të individit, në proceset gjyqësore dhe ato jashtëgjyqësore, asistencë në hartimin e dokumenteve juridike apo në forma të tjera që nuk përbëjnë ndihmë juridike parësore.

Ndiham Juridike dytësore është dhënia e shërbimeve të këshillimit, përfaqësimit apo mbrojtjes në proceset gjyqësore penale, proceset gjyqësore civile, si dhe paraqitjes para organeve administrative shtetërore.

Ndiham Juridike do të jepet edhe nëpërmjet edukimit ligjor të publikut përmes ndihmës që i ofrohet komunitetit me klinika lëvizëse, publikimeve, fushatave televizive dhe në median vizive si dhe masa të tjera të ngashme, duke u kushtuar vëmendje të veçantë nevojave të grupeve më në nevojë.



Cilat janë format e ofrimit së Ndihamës Juridike?

Ndiham Juridike do të jepet nëpërmjet:

- sigurimit të informacionit, dhënies së këshillimeve dhe shpjegimeve të çeshjeve juridike nëpërmjet intervistave të drejtëpërdrejta apo komunikimit në distancë;
- plotësimi i akteve juridike;
- këshillimi në vazhdimësi i personave që paraqiten vetë në gjykatë;
- përfaqësimi para organeve administrative;